



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

RAPORTI VJETOR I 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E BRENDSHME

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2020, Ministria e Brendshme (MB) ka planifikuar konsultimin e 23 (njëzetë e tre) projektakteve, 14 (katërmbëdhjetë) projektligje dhe 9 (nëntë) projektvendime të Këshillit të Ministrave.

Gjatë këtij viti Ministria e Brendshme, ka realizuar 83% planin e saj të konsultimit. Numri i përgjithshëm i projektakteve për të cilët është planifikuar konsultim gjatë vitit 2020 është 23 projektakte, nga ku MB ka realizuar procesin e konsultimit publik për 16 prej tyre.

Projektakte të konsultuara gjatë vitit 2020, janë të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 837, datë 24.12.20, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020”, i ndryshuar me VKM nr. 150, datë 19.2.2020.¹

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se për këto projektakte ka pasur një numër vizitorësh në rritje nga publiku dhe për njërin prej tyre, konkretisht ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””, janë përcjellë rekomandime apo komente përmes RENJK.

Publikimi në RENJK ka pasur një numër total prej 5492 vizitorësh për të 16 projektaktet e konsultuara në këtë platformë, ndërkohë që konsultimi publik nëpërmjet tryezave të konsultimit publik është zhvilluar vetëm për një akt, konkretisht ligjin “Për të huajt”. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të këtij të publik dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

¹Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/4/837>



Numri i përgjithshëm i akteve të planifikuara nga Ministria e Brendshme për konsultim publik gjatë vitit 2020 është 16 (gjashtëmbëdhjetë) projektakte, si vijon:

- Projektligji “Për të huajt”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”;
- Projektligji “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”;
- Projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378 datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, tën dryshuar;
- Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar”;
- Projektvendimi “Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027”;
- Projektvendimi “Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2021-2025”;
- Projektvendimi “Strategjia Kunder Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Renda 2021-2025”;
- Projektvendimi “Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026”;
- Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”;
- Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”;
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020-2024 dhe Planit të Veprimit për periudhën 2020-2022”;
- Projektvendimi “Plani i Veprimit dhe treguesit për Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore”.

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur. Ndërsa në nenin 4 të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i projektakteve të planifikuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2020, për Ministrinë e Brendshme është 65, nga ku janë miratuar 27 akte, duke i dhënë më shumë fokus akteve të paplanifikuara në PPAP, ku nga 47 prej tyre janë miratuar 33 projektakte.




2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga 23 akte të planifikuara për konsultim publik janë konsultuar 16 akte. Pra janë konsultuar 69% e tyre.

7 aktet të cilat nuk janë konsultuar janë:


1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" (është parashikuar në PPAP 2021 sepse nuk u hartua drafti nga grupi i punës në vitin 2020)
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076/2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në fushën e transportit, i ndryshuar" (parashikuar në PPAP 2020 për MB, por është iniciativë e MFE)
3. Projektligji “Për policinë bashkiake” (është parashikuar në PPAP 2021 sepse nuk u hartua drafti nga grupi i punës në vitin 2020)
4. Projektligji “Për Institutin e Kriminalistikës (është parashikuar në PPAP 2021 sepse nuk u hartua drafti nga grupi i punës në vitin 2020)
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” (nuk u hartua drafti nga grupi i punës në vitin 2020)
6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" (nuk u hartua drafti nga grupi i punës në vitin 2020).
7. Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë" të ndryshuar".

Numri i akteve të konsultuara në raport me numër total të akteve të parashikuara për konsultim publik sipas PPAP 2020, ilustron sipas grafikut më poshtë:



2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Me VNR janë konsultuar 5 projektligje.




2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për 38 projektakte, të cilat janë në përputhje me PKIE, PA dhe Dokumentet Strategjike, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike, ku pjesa më e madhe e tyre është përgjashtuar për kriterin e natyrës individuale të aktit administrativ, apo si marrëdhënie ndërkombëtare dhe marrëveshje dypalëshe/shumëpalëshe.

Më konkretisht:

- 2 akte janë përgjashtuar për kriterin “aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave”;
- 1 akt është përgjashtuar për kriterin “marrëdhënie ndërkombëtare dhe marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe”;
- 35 akte janë përgjashtuar për kriterin “aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ”.

Kriteret/përrjashtimet nga konsultimi publik



■ Totali ■ akte normative me fuqinë e ligjit ■ marrëdhënie ndërkombëtare/marrëveshje ■ akte administrative individuale

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e konsultuara janë kryesisht projektligje dhe projektvendime, ku përfshihen edhe strategjitë e ndryshme. Konkretisht i janë nënshtruar konsultimit publik 7 (shtatë) projektligje dhe 8 (tetë) projektvendime.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me një vit me parë, konkretisht viti 2019, në 2020 vihet re një numër më i madh akteve të konsultuara nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimin dhe konsultimin. Referuar situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, masat e shtrënguara kanë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve apo projektvendimeve, duke qenë se nuk janë zhvilluar takime publike me pjesëmarrje të shumë personave. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të këtij të publik dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të regjistrit elektronik për konsultimin dhe njoftimin RENJK;
2. Tryeza të konsultimit me aktorët e targetuar si: ekspertë, shoqëri civile apo organizata kombëtare/ndërkombëtare (të zhvilluara online për shkak të pandemisë);
3. Nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

Të gjitha projektaktet e planifikuara për konsultim për gjatë vitit 2020 iu nënshtruan konsultimit nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, dhe shumë pak prej tyre konsultimit nëpërmjet tryezave publike. Për më tepër metodatat e përdorura janë pasqyruar sipas grafikut si më poshtë:



2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit.

Numri i komenteve përmes:

- konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ishte vetëm 1 (një) edhe pse numri i vizitorëve në këtë portal për aktet e konsultuara ishte 5492.
- konsultimit me ekspertë të realizuara nga grupi i punës për hartimin e projektakteve ishte më i lartë.
- përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme asnjë koment.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, Ministria e Brendshme ka zhvilluar konsultime paraprake me teknikët apo ekspertët njohës të mirë të fushës së aktit i cili do të hartohet për disa prej projektligjeve/projektvendimeve.

Konkretisht për aktet si më poshtë:

- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”.
- projektligji “Për të huajt”
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””
- projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar”
- projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2020”
- projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe Plani i Veprimit 2021-2023”

- projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2022”
- projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Planit të saj të Veprimit 2021 -2023"
- projektvendimi "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Planit të Veprimit 2021 -2023"
- projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020-2024 dhe Planit të saj të Veprimit 2020 -2020”.

Pra nga numri total i akteve të planifikuara për konsultim për vitin 2020, janë konsultuar 16 prej tyre, nga ku 10 për shkak të natyrës teknike dhe komplekse të tyre, i janë nënshtruar konsultimit publik.

Ilustrimi sipas grafikut si më poshtë:



2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për të 16 aktet që i janë nënshtruar procesi të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJK, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune. Konsultimit për projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", është zhvilluar për një periudhë më të gjatë, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë që ka ky akt, konkretisht nga data 29.7.2019 deri më datë 18.12.2019.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2020, u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit. Kohëzgjatja mesatare e projektaktit ka qenë 20 ditë pune, referuar numrit më të madh të akteve që janë konsultuar sipas këtij afati.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit me parë, vihet re një numër më i madh akteve të konsultuara nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimin dhe konsultimin. Të dhënat e përfuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë në rritje, pavarësisht faktit se përcjellja e komenteve përmes këtij portali vazhdon të jetë në nivele të ulta. Por një numër më i vogël i akteve të konsultuara nëpërmjet tryezave të konsultimit me pjesëmarrjen e shumë aktorëve. Kjo për shkak të situatës së veçantë të krijuar nga pandemia Covid 19.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për vitin 2020 ka pasur një numër të madh të pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, konkretisht:

- Misionet/partnerët ndërkombëtare që ofrojnë bashkëpunim në fushën e sigurisë për Ministrinë e Brendshme si: ICITAP, PAMECA, OSBE, FRONTX;
- Organizata të tjera ndërkombëtare apo private si: RMSA, TLAS, CARITAS, IOM, UNHCR, Programi Suedez SCPA, etj;
- Ekspertë nga fusha akademike dhe njohës të mire të fushës së sigurisë, apo lëndëve plasëse si AKSHE;
- Ekspertë të organizatave si USAID, PLEP, HELITAS, STAR II, njohës të mirë të fushës së qeverisjes vendore dhe decentralizimit;
- Përfaqësues të Delegacionit Evropian, Këshillit të Evropës, përfaqësitë e ambasadave si: Ambasada Suedeze, Ambasada Italiane, Ambasada Zvicëre;
- Shoqëri të ndryshme civile, anëtarë të minoriteteve/pakicave;
- Sindikatat e arsimit, tregtisë, turizimit, punësimit, etj.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2020, ka pasur pjesëmarrje nga ekspertë të ndryshëm, të cilët janë kontraktuar nga MB ose kanë dhënë asistencën e tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme konsultuese si:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse,
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Ekspertët e fushave të ndryshme, kryesisht të sigurisë, apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, të përmendura sa më sipër, kanë dhënë kontributin e tyre konkretisht për këto akte:

- Projektligji “Për të huajt”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”;
- Projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar”;
- Projektvendimi “Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027”;
- Projektvendimi “Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2021-2025”;
- Projektvendimi “Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Renda 2021-2025”;
- Projektvendimi “Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026”;
- Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”;
- Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”;
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020-2024 dhe Planit të Veprimit për periudhën 2020-2022”;
- Projektvendimi “Plani i Veprimit dhe treguesit për Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore”.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga persona juridikë privatë, kryesisht përfaqësues të organizatave kombëtarë apo ndërkombëtare, ku ndër të cilët mund të përmendim: ICITAP, PAMECA, OSBE, FRONTX, RMSA, CARITAS, IOM, UNHCR, AKSHE; STAR II, Përfaqësues të Delegacionit Evropian, Këshillit të Evropës, përfaqësitë e ambasadave, shoqëri të ndryshme civile, anëtarë të minoriteteve/pakicave, sindikatat e arsimit, tregtisë, turizimit, punësimit, etj.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Brendshme. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga konsultimi përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, vetëm për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime për ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, është përcjellë një koment. Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes tryezave të konsultimit të zhvilluara në ambientet e Ministrisë së Brendshme apo ambiente të tjera të caktuara për një numër më të madh pjesëmarrësish, përfshirë dhe rastet e konsultimit të akteve nëpërmjet portaleve online, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID 19 dhe respektimit të kufizimeve të vendosura. Mesatarisht konstatohet një numër prej 5 komentesh për secilin projektakt të konsultuar nëpërmjet këtyre metodave.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Komentet e mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për aktet e sipërcituara e të konsultuara gjerësisht me grupet e interesit, kryesisht janë pranuar nga grupi i punës së hartimit të projektaktit apo nga struktura teknike.

Komenti për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime për ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, ardhur nëpërmjet RENJK, pasi u gjykua nga grupi i punës është refuzuar. Komentet e dhëna për projektligjin “Për të huajt”, janë pranuar pjesërisht dhe vetëm njëri prej tyre është refuzuar. Sugjerimet e dhëna nga grupet e interesit për strategjitë e përmendura më sipër, por kryesisht për Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, janë pranuar.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, pasi në hartimin e akteve të cilat janë konsultuar, institucioni është fokusuar në përmirësimin e tyre nga aktorët e targetuar apo organizatat që ofrojnë një bashkëpunim efektiv nëpërmjet ekspertizës së tyre. Pengesë në këtë proces ka qenë vetëm mungesa e zhvillimit të tryezave të konsultimit, duke u fokusuar më shumë në publikimin e aktit në RENJK, e cila theksojmë që ka një reagim me të vakët në krahasim me kontributin që merret për konsultimin e një aktin nëpërmjet takimeve publike.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Brendshme ka publikuar në RENJK 16 raporte konsultimi të akteve të planifikuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektateve për vitin 2020 dhe të konsultuara.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka raporte të pa publikuara për aktet e konsultuara. Çdo akt i konsultuar nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, është shoqëruar me raportin e rezultateve të këtij procesi, pavarësisht nëse janë marrë komente apo jo.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MB dhe është dërguar për raportim pranë kësaj njësie, argumentojmë si vijon:

Indeksi Performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme është 7.6. Ky rezultat vjen si pasojë e kësaj llogaritjeje: 123 është shuma e pikëzimit për procesin e konsultimit publik, pjesëtuar për numrin e akteve të konsultuara që është 16, indeksi rezulton 7.6.

Kurse në përqindje indeksi sasior rezulton 24%, pra 16 akte të konsultuara nga numri total prej 65 aktesh të planifikuara në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Brendshme, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.